



**V E N D I M**

**Nr. 8 Datë 25.01. 2008**

**PËR**

**DHËNIEN E LIÇENSËS PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE SHOQËRISË "OSSH" SH.A**

Në zbatim të nenit 9, nenit 13, pika 1, gërma c; nenit 14, pika 1, si dhe nenit 15, pika 1, të Ligjit Nr. 9072 dt. 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 862 dt. 20.12.2006 "Për Krijimin e Shoqërisë "OSSH" sh.a", dhe nenit 10, pika 1, nenit 16, gërma a, dhe nenit 19, pika 1, të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 21, dt. 04.04.2007, "Rregullores për Proçedurat e Liçensimit", Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij më dt. 25.01.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "OSSH" sh.a për marrje liçense për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike,

**V e n d o s i :**

- 1.** Dhënien e liçensës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë "OSSH" sh.a. për periudhën nga 25.01.2008, deri në 25.01.2028.
- 2.** Kjo liçensë jepet me kushtin që:
  - Shoqëria "OSSH" sh.a brënda datës 31.12.2008, të bëjë sigurimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me "Rregullat për Proçedurat e Liçensimit"
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 4.** Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.